



RAPORTI VJETOR 2019



Rreth FIQ

Qysh prej vitit 2000 FIQ punon me përkushtim për zhvillimin e modelit të qytetarisë aktive, të shëndetshme, të ndërtuar mbi angazhimin vullnetar të qytetarëve, përkrahjen dhe avokimin për individë, grupe formale e jo-formale në zona rurale e urbane me qëllim orientimin e politik-bërjes të nivelit lokal e qendror drejt përfshirjes cilësore të qytetarëve. Si i tillë, modelit i punës së FIQ ndër vite është një simbiozë bashkëpunimi me qytetarët, model ky që mundësoj një numër të madh protestash kundër termocentralit “Kosova e Re”; depozitimin e padisë kundër Bankës Botërore pranë Panelit të Inspektimit, lidhur me zhvendosjen e detyrueshme të qytetarëve të fshatit Hade komuna e Obiliq duke rezultuar kështu në tërheqjen e Bankës Botërore, Contour Global prej ndërtimit të TEC Kosova e Re.

Modeli i punës së FIQ-it mundësoj mbledhjen e mbi 33000 nënshkrimeve për 5 ditë në gjithë Kosovën, kundër vendimit mbi shtrenjtimin e rrymës në vend duke detyruar Kuvendin e Kosovës të diskutojë për resoluten me kërkesa të qytetarëve për ndryshimin e vendimit për rritjen e dyfishtë të çmimit të energjisë elektrike. Modeli i punës së FIQ-it ndër vite i bazuar në bashkëpunimin strategjik, përkrahjen, mbështetjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të OJQ-ve lokale kryesisht atyre jashtë Prishtinës bëri të mundur identifikimin e rigjallërimit të sektorit të shoqërisë civile me një qasje gjithëpërfshirëse dhe jo monopolizuese, e të orientuar drejt krijimit të kushteve për qëndrueshmëri dhe jo varësi të përhershme.

Rigjallërimi i sektorit të shoqërisë civile në Kosovë kërkon akterë të rinj, ide të reja e sigurisht dhe trainime të përpi-luara në varësi të nevojave individuale të organizatave lokale dhe kushteve nëpër të cilat lindin dhe krijohen iniciativa të reja komunitare. Ky model partneriteti i FIQ-it me OJQ-të lokale, grupet jo formale, individë hulumtues, studentë i hapi rrugët krijimit të hapësirave dhe hartimit të paketave të trainimeve falas nëpërmjet Qendrës Burimore të Kosovës/FIQ (mbështetur prej EUOK).

Identifikimi ideve inovative dhe zhvillimi i ekonomisë së gjelbërt përkundër orientimeve për investime në tëngjill; nxitja e zhvillimit të kuadrit ligjor dhe njëherazi të programit përsheptues të vetë-punësimit për të rinj, gra e vajza; zhvillimi dhe promovimi i ndërmarrësisë sociale nëpër të gjitha komunat e Kosovës, zhvillimi i modelit origjinal të start-ups në bujqësi, mjedis, ICT, ecotourism; rritja e kapaciteteve avokuese të OJQ-ve lokale, I japin FIQ-it dimensionin e një hub – qendër që mirëpret qytetarin në nevojë, organizatat rinore të interesuara për të zhvilluar kapacitetet e veta organizative, ekspertët e mjedisit, punësimit, gazetarë të Kosovës, Ballkanit Perëndimor, BE-së apo dhe përtej kontinentit me qëllimin parësor atë të fuqizimit të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë si një prej treguesve jetik të cilësisë së demokracisë në vend.

Përgjatë jetës dhe aktivitetit tone kemi kuptuar, realizuar dhe po e promovojmë nevojën për të krijuar kulturën e besimit të njeri-tjetrit, të autoritetet publike (nëpërmjet transparencës, llogaridhënies e përfshirjes, tek donatorët (nëpërmjet krijimit të partneriteteve reciproke) sepse besimi ndihmon në përballjen me sfida lokale apo nacionale, individuale, apo kolektive dhe si i tillë i kontribuon zhvillimit të kohezionit social të shoqërisë.

Fjala e Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive e FIQ

Të nderuar miq,

Viti që shkoj, shënoj momente të shumta suksesi për Forumin për Iniciativa Qytetare dhe të gjithë partneret, bashkëpunëtorët në fusha e sektorë të ndryshëm.

FIQ njohu dhe zhvilloj partneritete të reja duke kontribuar kësisoj në pasurimin e sektorit të shoqërisë civile me organizata të reja komunitare. Tashmë më shumë se 30 OJQ të reja e me profile të ndryshme janë një realitet i ri për komuna si: Ferizaj, Gjiilan, Ranillugë, Prizren, Kamenicë, Pejë, Prishtinë, Mitrovicë, Graçanicë, Drenas Novobërd, Kaçanik etj në sektorë si edukimi, shëndetësia, mjedisi, sporti, kultura, të drejtat e njeriut, ndërmarrësi, bujqësi, ICT etj.

Falë **partneritetit strategjik** me EUoK - Zyrën e BE-së në Kosovë, FIQ tashmë është transformuar në një hub-qendër burimore në funksion të plotë dhe në shërbim të OJQ-ve komunitare, por jo vetëm. Tashmë Qendra Buri-more e Kosovës/FIQ është adresa e shumë OJQ-ve për të gjithë Kosovën, e kërkuesve dhe hulumtuesve të pavarur, medieve, partnerëve të rajonit, apo dhe përtej.

Në cilësinë e **përfaqesimit** të të gjithë rrjetit të OJQ-ve lokale jashtë Prishtinës, FIQ merr pjesë rregullisht dhe kontribuon me ekspertizë, e njohuri në Këshillin për Bashkëpunim Qeveri-Shoqëri Civile.

Në vazhden e promovimit të **ndërmarrësisë**, FIQ është inovator në zhvillimin dhe promovimin e suksesshëm të Programit të Përsheptimit të Vetë-punësimit të të rinjve në Kosovë. Në 2019 patëm kënaqësinë të mbështesim me 160,000.00 euro ndërmarrës të rinj në shumë prej komunave të Kosovës.

Sigurisht, që dhe 2019 ashtu sikurse dhe vitet pararendëse, u përmbyll me ngjarjen me serioze dhe kuptimplotë, FI-DES çmimet për **kontribut filantropik** në nivel individual, korporativ në Kosovë e Diasporë.

Mirëpo, në fund të mesazhit tim për gjithë ju lexues, miq e bashkëpunëtorë, më lejoni te vlerësoj si një prej momenteve me kulminante ate te angazhimit emergjent për mbledhjen dhe ndihmesen për të dëmtuarit prej tërmetit të 26 Nëntor 2019 në Shqipëri. Ishte kjo ngjarje një moment, që nxorri në pah kapacitetet e aftësinë e FIQ-it për tu vetë-organizuar, mobilizuar ndihma humanitare me shpejtësi, e për ti shpërndarë ato pranë të dëmtuarve dhe familjeve në nevojë.

Jam e bindur, se suksesi i FIQ do të njihte rezultate të papërfillshme, nëse vizioni jonë nuk do të kombinohej me aftësinë për të bashkëpunuar me të tjerët!

Faleminderit për mbështetjen!



160 000 euro për sipërmarrësit e rinj

Vetë-punësimi, ndërmarrësia e të rinjve, grave e vajzave vazhdon të jetë boshti i punës së FIQ-it.

Forumi për Iniciativa Qytetare bashkë me Link Campus University nga Italia, kanë vazhduar projektin e suksesshëm “Përsheptimi i vetpunësimit dhe ndërmarrësisë në Kosovë”, financuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë. Pas përzgjedhjes së ideve më premtuese për sukses, u ndanë 20 grante nga 8000 euro për ndërmarrës të rinj në fushat e bujqësisë dhe teknologjisë e informacionit. Në një ceremoni rasti, çmimet për fituesit u ndanë nga Drejtori I Programeve në FIQ, Kushtrim Puka dhe Shefi I sektorit politik në Zyren e BE-së në Kosovë, Ricardo Ferri.



Forumi për Iniciativa Qytetare së bashku me tre përfitues të projektit “Përsheptimi i vet-punësimit dhe ndërmarrësisë në Kosovë”, kanë qëndruar në Romë për vizitë studimore në universitetin italian, Link Campus University, që njëherazi është edhe partner i projektit #ATAR2. Pjesëmarrësit nga Kosova, u mirëpritën nga themeluesi dhe presidenti i Link Campus, Vincenzo Scotti, dhe Eldriona Daci, si pjesë e projektit nga Link Campus.

Ndërmarrësit tanë patën rastin dhe mundësinë të takojnë nga afër ndërmarrësit italian që janë pjesë e akseleratorit të bizneseve, Innova, ndërmarrësin dhe ekspertin e fushës së arteve, Michele Gerace, poashtu prezantimin dhe diskutimin shumë të rëndësishëm me njërin nga themeluesit e Forëard Fooding, Max Leveau.

Fjolla, Argnesa dhe Rinori prezantuan idetë e tyre të biznesit para ekspertëve të ndërmarrësisë nga Link Campus, Dario Carrera dhe Carola Pennacchiotti. Mentor i pjesëmarrësve gjatë prezantimeve ishte themeluesi dhe drejtori ekzekutiv i ARMNet, Simeone Demelas.



Vizita studimore në Itali e përfituesve të FIQ

Rinor Shabani, njëri nga pjesëmarrësit në Itali, shprehet se fillimisht ka qenë shumë skeptik se a do të jetë një nga përfituesit e projektit dhe se është hera e parë, që ai përfiton nga ndonjë projekt dhe është tejet i kënaqur me komunikimin dhe me gjithçka rreth projektit. Ndërkaq Fjolla shpreson se “do të ketë shumë më shumë projekte si ky, ku të rinjtë do të mund të përfitonin si ne, nga FIQ dhe projekti ATAR2”. Argnesa, shpreh kënaqësinë që ka pasë rast të bashkëpunoj me FIQ dhe ka përfituar përveç grantit edhe nga trajnimet dhe vizita në Itali.

Projekti #ATAR2 është i financuar nga Bashkimi Europian, i menaxhuar nga zyra e Bashkimit Europian në Kosovë dhe implemetuar nga FIQ dhe LINK Campus University.



FIQ kontribuon për një shoqëri më demokratike

Përmes projektit “Nxitja e Zhvillimit të Qëndrueshëm Organizativ të OSHC-ve në Kosovë” i financuar nga Bashkimi European dhe i përbërë nga tre komponent; Akademia e Qëndrueshmërisë, Qendra Burimore dhe skema e dhënies së granteve, Forumi për Iniciativa Qytetare ka arritur të rrisë zërin e Organizatave të Shoqërisë Civile për zhvillim të demokracisë dhe përmirësim të jetës sociale.



Përgjatë vitit 2019 Akademia e Qëndrueshmërisë ka arritur të jetë burimi kryesor i informacionit i organizata të shoqërisë civile. Mbi 100 organizata kanë marrë pjesë në paketën e trajnimeve të akademisë për ngritjen e kapaciteteve në mënyrë specifike që ato të pajisen me aftësitë dhe kompetencat e kërkuara për zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave të suksesshme të avokimit.

FIQ këtë vit ka hapur dyert e saj duke krijuar Qendrën e Burimeve dhe ka ofruar sallë konferencash dhe një sallë mbledhjesh falas ku mbi 100 organizata kanë kryer punë administrative për të realizuar qëllimet dhe objektivat e tyre.



Në kuadër të projektit, FIQ ka ndarë 15 grante për organizata të shoqërisë civile me iniciativa të cilat kanë kontribuar në zhvillimin e fushave si edukim, mjedis, filozofi, mjekësi, art, sport e psikologji. Si rezultat i fazës së parë janë krijuar 4 koalicionet tematike të OSHC-ve të cilat do bashkëpunojnë për iniciativa të ardhshme.

Lansohet strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqëri civile.

Strategjia qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023, ka katër objektiva kryesore, ku më e rëndësishmja është rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikëbërje. Ndër objektivat tjera të kësaj strategjie janë rritja e llogaridhënies dhe transparencës në financimin publik për OSHC-të, zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike, dhe rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programet me interes publik.

Dajana Berisha, në cilësinë e Përfaqësueses së Qendrës Burimore të Kosovës për Shoqëri Civile, tha se bashkëpunimi ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile është ende i brishtë megjithë ndihmën përmbajtësore të Zyres së BE-së në Kosovë. Kjo për shkak se ka munguar qasja gjithëpërfshirëse ndaj shumicës së OJQ-ve që veprojnë jashtë kryeqytetit. E ardhmja e këtij bashkëpunimi duhet të njohë dimensione të reja, që synojnë transparence në vendim-marrje, gjithëpërfshirje, përfaqësim real të konstituencisë së vërtetë dhe e gjitha kjo me qëllimin final atë të realizimit të impaktit të vërtetë në terren, arritjes së kohezionit shoqëror në shoqëri dhe për orientimin de-facto të Kosovës drejt EU.



FIQ vazhdon ligjeratat tradicionale mbi filantropinë

FIQ, gjatë vitit 2019 vazhdoi të organizoj ligjerata mbi Filantropinë në Kosovë. Këto ligjerata u organizuan nëpër shkolla dhe fakultete të ndryshme, ku të rinjtë patën mundësi të mësojnë më shumë rreth filantropisë, mbi formën e dhurimeve të parave, praktikat filantopike dhe sektorët që kanë nevojë për përmirësim. Të rinjtë vazhdojnë të shprehin ide inovative me ndikim në jetën e përditshme, dhe bindjet e tyre mbi vlerat e përbashkëta që jetësohen përmes filantropisë. Ata si zakonisht reflektojnë për aktivitete që do të donin të angazhoheshin personalisht, dhe vizionin e tyre për vitet e ardhshme në Kosovë. Energjia pozitive që përcillet nga të rinjtë, është forca e ndryshimeve për vendin.



KOSID organizon konferencën “Tërheqja e Bankës Botërore nga investimet në thëngjill në Kosovë dhe gjendja aktuale e sektorit të mjedisit dhe energjisë”

Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID) organizoi më sukses konferencën “Tërheqja e Bankës Botërore nga investimet në thëngjill në Kosovë dhe gjendja aktuale e sektorit të mjedisit dhe energjisë”. Kjo konferencë ofroi mundësi për një dialog midis palëve vendore dhe ndërkombëtare me ekspertizë në fushën e mjedisit dhe energjisë, në lidhje me efektin e saj në politikat mjedisore dhe eficientë e energjisë.

Ndryshimet klimatike, tashmë janë bërë pjesë e qenësishme e punës avokuese të KOSID. Tërheqja e Bankës Botërore prej investimeve në Thëngjill në Kosovë solli në pah nevojën për një diskutim të hapur dhe gjithëpërfshirës me akterë vendore e ndërkombëtare me ekspertizë në fushën e energjisë, mjedisit, bashkëpunimit rajonal dhe të ardhmen europiane të Kosovës në EU.



Çka mbas tërheqjes së Bankës Botërore prej investimeve në Thëngjill?

Cili mund të jetë roli i OPIC/DFC në mbështetje të zhvillimit të Kosovës?

Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm, KOSID dhe partnerët, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Evropë publikojnë letrën e dyte të dërguar OPIC/DFC (institutcion financiar i qeverisë Amerikane për investime private) se pse duhet të mos e mbështesin ndërtimin e termocentralit e qymyrit “Kosova e Re” dhe të fokusohen në zhvillimin e qëndrueshëm dhe energjinë e ripërtritshme në Kosovë.

Aktivitetet e avokimit të KOSID kundër investimeve në thëngjill në Kosovo kanë argumentuar se një mbështetje e mundshme për termocentralin e ri të qymyrit do të ishte në kundërshtim me politikat OPIC-ut që e kundërshtojnë thëngjillin dhe inkurajojnë mbështetjen e energjisë së rinovueshme; Kongresi Amerikan i ka kërkuar OPIC-ut t’i mbështesin dhe tu japin përparësi burimeve e ripërtëritshme dhe projekteve të energjisë së pastër; Termocentrali i ri i qymyrit nuk mund të përmbushë statutin e OPIC për ndalimin e mbështetjes së projekteve me ndikim të paarsyeshëm; KOSID i propozon OPIC-ut alternativa me të lira dhe ekonomikisht më të volitshme që janë në dipozicion për të përmbushur nevojat energjetike të Kosovës.



Grante për rininë në Kaçanik

Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) nëpërmjet projektit PREX synon që të rritë mundësitë e angazhimit të rinjëve në **Kaçanik**, punësimin dhe vetë-punësimin e tyre, të ofroj qasje në resurset e komunitetit nëpërmjet OJQ-ve rinore, shkëmbimeve edukative, rrjetëzimi si dhe ndihmë grupeve vullnetare që kanë për bazë aktivizmin.

Duke targetuar të gjitha këto elemente nëpërmjet intervenimeve tona, FIQ synon të përfshij të rinjtë në proces të zhvillimit të qëndrueshëm, nëpërmjet qasjes proaktive e cilat parandalon ndonjë rrezik që mund t'i haset këtyre grupeve të rinjëve. Projekti ka filluar në Shtator të vitit 2017 dhe do të vazhdoj deri më 2020, pasi që të jenë përmbytur të gjitha objektivat e parashikuara. Gjatë këtij projekti do të përfitojnë jo më pak se 2300 të rinj nga komuna e Kaçanikut.

Si rezultatet e aktiviteteve të projektit pritet që të themelohen së paku 20 ndërmarrësi të reja duke krijuar vende të reja të punës si dhe së paku 20 organizata apo forume rinore të riaktivizohen dhe të kalojnë nëpërmjet programit të Akademisë së bazuar në komunitet.

Vizitë te përfituesit e PREX, përmes fotove




FIQ publikon analizën e kornizës ligjore për ndërmarrjet sociale në Kosovë

Forumi për Iniciativa Qytetare ka publikuar analizën e kornizës ligjore për ndërmarrjet sociale në Kosovë, përpiqet nga Qerkin Berisha, ekspert ligjor. Kjo analizë trajton Ligjin për Ndërmarrje Sociale, kryesisht nga aspekti ligjor, duke përfshirë formën e organizimit, regjistrimin dhe përfitimin e statusit të ndërmarrjes sociale dhe marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale. Përveç kësaj, dispozitat e këtij ligji janë analizuar edhe nga aspekti i zbatueshmërisë së tyre praktike, duke trajtuar edhe çështjet kundërtëhënës dhe ato që kërkojnë sqarime të mëtejme.

FIQ-i aksion bamirësie për të prekurit nga tërmeti në Shqipëri

Duke bashkëndjerë dhimbjen dhe trishtimin me qytetarët në Shqipëri, Forumi për Iniciativa Qytetare, (FIQ) ka hapur dyert për ndihma nga qytetarët e Kosovës. Drejtoresha e Forumit për Iniciativa Qytetare (FIQ), Dajana Berisha, ka thënë për EkonomiaOnline se iniciativa e tillë ka për qëllim solidarizimin me të prekurit nga kjo tragjedi. “Po mendoj është një iniciativë shumë njerëzore për atë çfarë ka ndodhë në Shqipëri. Qytetarët e dinë se tërmeti i jashtëzakonshëm ka dëmtuar Bashkinë e Durrësit, komplet fshatrat përreth të kësaj bashkie, në zonat e plazhit ka viktima, ndër ta edhe fëmijë, kështu që kemi ndërmarrë këtë iniciativë”, thotë ajo me lot në sy. Me lot në sy, Berisha tha se është ndjenjë e mirë kur sheh qytetarët e Kosovës teksa u vijnë në ndihmë banorëve të prekur nga ky termet. “Është një ndjenjë e jashtëzakonshme, është shumë humane dhe në fund të ditës ne jemi një komb jemi njerëz dhe ndjejmë njësoj, sidomos për dhimbjen, kështu që për mua do të thotë shumë sepse për gjysmë ore njerëzit kanë filluar të sjellin ato që janë të nevojshme për viktimat dhe familjet e dëmtuara, batanije, veshje për dimër dhe mbulesa e shtretër, sepse në Durrës tashmë janë hapur tenda”, ka thënë ajo.



Muaji i filantropisë

Gjatë periudhës tetor-nëntor 2019, Forumi për Iniciativa Qytetare organizoi Muajin e Filantropisë, ku një mori aktiviteteesh u organizuan në kuadër të tij.

Forumi filantropik i grave, i parapriu aktiviteteve që shënjuan Muajin e Filantropisë, tashmë tradicional. Si i tillë, ky forum, mbledhi rreth vetes gra nga fushëveprimtari të ndryshme, të cilat diskutuan mbi sfidat dhe sukseset e veta. Nën përkujdesjen e Dajana Berishës, Drejtore Ekzekutive e FIQ, gra shumë të suksesshme, përfaqësues nga tre sektorë, ai publik, shoqëria civile / akademia dhe përfaqësues diplomatikë me qëllim elaborimin e udhëheqjes së grave dhe aftësive të tyre për të mobilizuar mbështetjen financiare për avancimin e grave të reja në fusha të ndryshme të zhvillimit në Kosovë. Panelistet për Forumin Filantropik të Grave 2019, ishin Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive FIQ; Leonora Kusari, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD); Kaltrina Zeka, Grupi për Familjet në Nevojë; Gyli Beqiraj, Radio Televizioni 21; Havushe Bunjaku, Themeluese e Ndërmarrjes Sociale 99 Lule; Klodiana Karaj, Ambasada e Shqipërisë dhe Teuta Fazliu, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.



Publikimi i Analizës mbi Legjislacionin e Kosovës lidhur me filantropinë dhe OJQ-të, ishte aktiviteti tjetër, që u organizua gjatë Muajit të Filantropisë. Analiza, e shkruar nga eksperti i çështjeve juridike, z. Qerkin Berisha, trajton mënyrat e financimit të OJQ-ve dhe nevojën për institucionalizimin e mëtejme të filantropisë.

Gjatë fjalës së saj hyrëse, Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive e FIQ, theksoi se shoqëria civile në Kosovë kryesisht është financuar dhe financohet nga ana e donatorëve të huaj, institucioneve publike dhe më pak nga ana e sektorit privat. Duke pas parasysh që përkrahja e donatorëve të huaj ka shënuar rënie gjatë viteve të fundit, dhe poashtu në të ardhmen mund të ketë rënie të mëtejme, sektori i shoqërisë civile do të duhej të orientohej në fondet dhe financimin që që do të sigurohej përbrenda Kosovës.

Pas prezantimit të kësaj analize, pati diskutime të shumta, sidomos për fondet publike, të cilat me bërjen publike të të gjitha donacioneve që japin, kanë arritur vlerën e 20 000 000 eurosh në vit (2018), për cka deri më 2017 nuk kemi pasë njohuri kush ka përfitu nga këto fonde. Lidhur me këtë, të pranishmit u pajtuan se duhen bërë thirrjet për aplikime më strikte, shumë më konkrete dhe monitorimi të pësojë ndryshime bazuar në rregulla më të sakta. Kjo edhe për arsye të transparencës edhe llogaridhënies nga institucionet për këto fonde, që në fakt janë fonde që vijnë nga tatimpaguesit kosovarë dhe mos lenjes së hapësirës për dyshime se fondet po jipen me klane dhe grupime të caktuara.



FIDES 2019

Për të njëmbëdhjetin vit me rradhë, Forumi për Iniciativa Qytetare, organizoi Ceremoninë e ndarjes së çmimeve për filantropi FIDES 2019. Në një atmosferë të ngrohtë, në ambientet e Muzeut Kombëtar të Kosovës, me këtë Çmim, u nderuan filantropët e vitit, ata që kanë kontribuar në mënyrë sistematike në të mirën e përgjithshme.

Ceremoninë e ndarjes së Çmimeve FIDES 2019, e hapi znj. Dajana Berisha, Drejtore Ekzekutive e Forumit për Iniciativa Qytetare, e cila ndër të tjera, në fjalën e saj të rastit u shpreh: “Urojmë që kjo darkë e filantropisë të jetë një ogur i mbarë për zgjidhje të situatës politike nëpër të cilën po kalon Kosova.”


Çmimi FIDES për kontribut kombëtar “Hasan Prishtina”, me plot meritë u nda për heronjtë tanë, që jetën e tyre e vunë në rend të dytë, duke treguar gatishmërinë t’i dalin në mbrojtje e shpëtim, mu ashtu sic e kërkon detyra, vëllezërve tanë matanë kufirit, Forcës së Sigurisë së Kosovës. Këtë Çmim në emër të FIQ, e ndau, z. Albin Kurti, i cili në fjalën e tij të rastit tha “Ky çmim na kujton, se detyrat tona të përditshme na duken si një rutinë e pakuptimtë. Puna e mësuesit, policit mund të duken të zakonshme por ajo është jetike për nxënësit dhe qytetarët. Ndiheh i nderuar që ndaj çmimin Hasan Prishtina, këtë e bëjmë për FSK-në ushtarët tanë, që treguan përkushtim dhe profesionalizëm duke shpëtuar njerëz në Durrës e Thumanë. Ju jeni ushtarët e vërtetë, edhe Hasan Prishtina do të ndihej krenar po të ishte sot këtu”, u shpreh Kurti.

Çmimi FIDES 2019 për kontribut korporativ; për investime në ekologji, në krijimet e parqeve në qendra të ndryshme të vendit, investime strategjike në arsim dhe shëndetësi iu nda AL TRADE Center. Këtë Çmim në emër të FIQ, e ndau znj. Vjosa Osmani.

Çmimi FIDES 2019 për kontribut individual, për mbledhje fondesh dhe investim në infrastrukturën bazike në disa shkolla fillore të Kosovës, shkoi për Caleb Jones, djalosh nga Amerika, i cili në fjalimin e tij, falenderoi FIQ-in për Çmimin, duke u shprehur i mrekulluar me punën tonë dhe në të njëjtën kohë tha se ky Çmim do të jetë një shtysë e madhe për vazhdimësinë e projekteve të tij edhe në të ardhmen në vendin tonë. Këtë Çmim në emër të FIQ, e ndau Z. Ray Naylor nga Ambasada Amerikane në Kosovë.


Çmimi FIDES 2019 për kontribut nga diaspora, për investime sociale dhe kulturore, e mori Arta Krasniqi Trepca. Këtë Çmim në emër të FIQ, e ndau znj. Nasrin Pourghazian nga Ambasada Suedeze në Kosovë.





FIQ ne media





FIQ-i ndan çmimet FIDES 2019, FSK-ja shpërblehet për ndihmën e dhënë Shqipërisë LIVE

More from Ekonomia Online
☒ Autoplay next video

 FIQ-i ndan çmimet...
 Ekonomia Online





FIQ

Forumi për
Iniciativa Qytetare

www.fiq-fci.org